

VENDIM
Nr.460, datë 23.6.2005

PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VENDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 111 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1996 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 2 e 5 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paga bazë minimale mujore e punonjësve, në shkallë vendi, e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 11 800 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë.
 2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës.
 3. Paga bazë minimale orare të jetë 68 (gjashtëdhjetë e tetë) lekë.
 4. Shtesat, me karakter të përhershëm, jepen mbi pagën bazë.
 5. Vendimi nr.405, datë 25.6.2004 i Këshillit të Ministrave “Për pagën minimale në shkallë vendi” shfuqizohet.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 gusht 2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano